



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM

Nr. 61, datë 24. 10. 2022

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË BONUSIT TË QIRASË SË BANESËS,
FAMILJES XHEMAL ISLAMAJ, BANOR I NJËSISË ADMINISTRATIVE
ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24. 10. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 24, “Funksonet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Ligjin Nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si dhe VKB- në Nr. 65, datë 24.12.2021 “Për miratimin e PBA 2022-2024 dhe buxhetit vjetor 2022, të Bashkisë Skrapar dhe institucioneve në varësi të saj”

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e bonusit të qirasë së bancesës, familjes së Xhemal Islamaj, banor i Njesisë Administrative Çorovodë, Bashkia Skrapar, për periudhën Nëntor 2022 – Nëntor 2023, në vlerën 5000 (pesëmijë) lekë në muaj.
2. Vlera prej 60.000 (gjashtëdhjetëmijë) lekë në total për periudhën, do të përdoret nga Bashkia Skrapar nga artikulli 602, zëri buxhetor “Shpenzime Operative”.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 11 vota pro , vota kundër – s’ka , vota abstenim – s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

